



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva
Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport



TEATRI/THEATRE
AVDUSH HASANI

Bazuar në Nenin 8, Nenin 10 Paragrafi 2 Nënparagrafi 2.1 të Ligjit të Punës Nr 03/L-2012, Nenin 17 Paragrafi 1 të Ligjit për Teatrot Nr. 04/L – 106, Statutin e Teatrit Nenit 21 për Funkcionimin e Ansamblit të Teatrit të Qytetit si dhe Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komuna e Podujevës shpallë:

KONKURS PUBLIK
Për punëtorët tjerë të Teatrit të Qytetit

Institucioni: DKRS/ Teatri “Avdush Hasani”

1. Titulli i punës: Asistent administrativ (1 pozitë)

Koeficienti: 6

Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 muaj)

I përgjigjet: Drejtorit të Përgjithshëm

Orari i punës: 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Siguron mbështetje të përgjithshme administrative në funksion të veprimtarisë së teatrit, përfshirë posten zyrtare, skanim, faksim dhe kopjim të dokumentave, plotësimin e raporteve të shpenzimeve, si dhe hartimin e dokumentave për takime të ndryshme
2. Përgatit dhe modifikon dokumentet, e-malin zyrtar
3. Ruan dhe mbirëmbanë systemin elektronik, kopjet fizike të dokumenteve dhe dosjeve
4. Menaxhon kalendarin e shfaqjeve dhe ngjarjeve tjera nga veprimtaria e Teatrit
5. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjin dhe rregulloret për funksionimin e Teatrit

Kualifikimi, Aftësitë, Përvoja dhe karakteristikat personale

1. Arsimim Bachelor, Fakulteti Juridik, trajnim përkatës si dhe përvojë pune në fushën përkatëse teknike ose administrative;
2. Shkathësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të përpunuar informata dhënë udhëzime dhe përcjell informata tek të tjerët
3. Aftësi koordinimi me personelin e teatrit
4. Shkathtësi kompjuterike ne aplikacione të programeve(Word, Exel, Power Point, Access)

2.Titulli i punës: Mjeshtër ndriçimi (1 pozitë)

Koeficienti: 6

Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 muaj)

I përgjigjet: Drejtorit të Përgjithshëm

Orari i punës: 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- 1.Bënë disajnimin e dritave për shfaqjet e teatrit
- 2.Kujdeset për funksionimin dhe mirëmbajtjen e pultit të ndriçimit
- 3.Mirëmbanë rrjetin elektrik në teatër
- 4.Sipas nevojës kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjin dhe rregulloret për funksionimin e Teatrit
- 5.Të ketë aftësi të mira për komunikime ndër-njerëzore dhe të jetë i gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës.

Kualifikimi, Aftësitë, përvoja, dhe karakteristikat personale

- 1.Të ketë së paku Diplomën e Shkollës së Mesme, Drejtimi Teknik
- 2.Njohja e punës praktike me miksetën digjitale të ndriçimit
- 3.Njohja e punës praktike me sistemin elektrik
- 3.Shkathësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të përpunuar informata dhënë udhëzime dhe përcjell informata tek të tjerët
- 4.Aftësi koordinimi me personelin e teatrit
- 5.Shkathtësi kompjuterike ne aplikacione të programeve(Word, Exel, Power Point, Access)

3. Titulli i punës: Mjeshter i skenografisë (1 pozitë)

Koeficienti: 7

Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 muaj)

I përgjigjet: Drejtorit të Përgjithshëm

Orari i punës: 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Të realizojë skenografinë për shfaqjet e Teatrit, sipas kërkesave të skenografit
2. Të organizojë dhe kordinojë punën me puntorët e skenës dhe personelin tjetër teknik
3. Të kujdeset dhe të mbirëmbajë skenografitë për shfaqjet në repertor dhe për magazinimin e tyre
4. Të kujdeset dhe të mbirëmbajë rekuizitat e teatrit
5. Të kryej edhe punë tjera sipas kërkesave të teatrit bazuar në Ligj

Kualifikimi, Aftësitë, Përvoja dhe karakteristikat personale

1. Diplomë universitare, Fakulteti i Arteve
2. Shkathësi komunikimi, dhe aftësi për të punuar në kushte të vështirësuar
3. Aftësi koordinimi me personelin e teatrit
4. Shkathësi kompjuterike në disajnimin e skenografisë dhe hapësirës skenike dhe në aplikacione të programeve të avansuara
5. Dëshmi të punës paraprake, referenca.

4. Titulli i punës: Koordinator për marketing (1 pozitë)

Koeficienti: 6

Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 muaj)

I përgjigjet: Drejtorit të Përgjithshëm

Orari i punës: 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Krijon, zhvillon dhe Implementon kampanjat e marketingut me qëllim të promovimit të Teatrit , shfaqjeve dhe aktiviteteve tjera të teatrit
2. Koordinon punën me përgjegjësit e teatrit për aktivitetet/eventet promovuese
3. Menaxhon dhe mirëmbanë aktivisht faqen elektronike të teatrit Website, fcb dhe prezencen e Teatrit në mediat elektronike dhe të shkruara në funksion të promovimit të punës së teatrit
4. Krijon dhe menaxhon disajnimin e PR (Pijarit) për prezatimet e teatrit
5. Bënë strategjinë promovues të produkteve të teatrit
6. Merret me organizmin dhe postimin e ftesave dhe parqitjeve në festival apo turne
7. Kryen edhe detyra tjera qe kanë të bëjnë me promovimin e institucionit, programeve, shërbimeve sipas kërkesës së mbikqyrësit, bazuar në ligj

Kualifikimi, aftësitë, përvoja, dhe karakteristikat personale

- Kandidati/ja duhet të ketë diplomë universitare ne fushën e Marketingut, apo të Arteve; Trajnime /Certifikatë në fushën relevante
- Të ketë njohuri për funksionimin e teatrit si institucion dhe art
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze
- Aftësi të mira menaxheriale dhe përpikmëri
- Aftësi të mira në komunikim verbal dhe të shkruar
- Të jetë i/e motivuar, profesional dhe qasje pozitive
- Të jetë fleksibil dhe kreativ duke marrë parasysh edhe kushtet e vështirësuara të punës

5.Titulli i punës: Punëtor skene (1 pozitë)

Koeficienti: 5

Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 muaj)

I përgjigjet: Drejtorit të Përgjithshëm

Orari i punës: 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Të kryej punët fizike në përgatitjet e skenografisë
2. Të realizojë detyrat e punës për vendosjen e dekorit dhe rekuizitave në skenë
3. Të kujdeset për pastërtinë e sallës dhe objekteve përcjellëse të teatrit
4. Mbanë rendin në sallë sipas nevojës dhe shpërndanë posterat dhe reklamat tjera të teatrit
5. Kryen edhe detyra tjera që kanë të bëjnë me punën e teatrit programeve, shërbimeve sipas kërkesës së mbikqyrësit, bazuar në ligj.

Kualifikimi dhe aftësitë e kërkuara:

- 1.Të ketë së paku Diplomën e Shkollës së Mesme
- 2.Shkathësi komunikimi, dhe aftësi për të punuar në kushte të vështirësuara
- 3.Aftësi koordinimi me personelin e teatrit
- 4.Shkathësi në përdorimin e mjeteve të punës të nevojshme për punimin e skenografisë

Dokumentet e nevojshme që kërkohen:

- Certifikatën e lindjes
- Kopjen e letërnjoftimit
- Diplomen e shkollimit të kryer të nivelit përkatës (fotokopje e vërtetuar)
- Dëshmitë për përvojë pune
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore (për arsye të minimizimit të shpenzimeve të kandidatëve kërkohet në fund të procedurës së rekrutimit vetëm nga kandidati më i suksesshëm)
- Dokumentet i dërgoni fotokopje sepse të njëjtat nuk kthehen

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Komuna e Podujevës ofron mundësi të barabarta punësimi dhe i mirëpret kërkesat e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë dhe të femrave.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do t'i nënshtrohen intervistimit .

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë duke filluar nga data e publikimit më **17.06.2020** deri më datën **01.07.2020** që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit. Fletëaplikacionet merren në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, në ndërtesën e Kuvendit të Komunës.

Kërkesat me dokumente të kompletuara dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë. Kërkesat e kandidatëve me dokumente të pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit refuzohen.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni në Zyrën e personelit, në këtë numër të telefonit 038/ 570 – 732 / lok .126.

Dt.17.06.2020
Nr. 09-111/01-28413/20



Drejtori i Teatrit të Qytetit
Agron Gërguri